

## PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

- **Objekti i procedurës:** “Kryerja e shërbimit të inspektimit të pajisjeve navigacionale dhe procedurave të fluturimit nga ajri (flight check)”.
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (F.P.P.):** 38110000-9 Instrumenta lundrimi.
- **Vlera e fondit limit: 15 796 666** *(pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshur, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albcontrol** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

**Argumentimi:** *kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i L.P.P. “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë**

#### **2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

**2.1.1** Operatorët Ekonomikë që do të marrin pjesë në procesin e prokurimit për marrjen përsipër të realizimit të Kalibrimit të paisjeve nga Ajri (Flight Check), **duhet të paraqiten në Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) në mënyrë që të merret Aprovimi prej tij.**

Dokumentacioni i nevojshem përcaktuar në specifikimet teknike që do të dërgohet për aprovim në Autoritet si dhe konfirmimi nga Autoriteti I Aviacionit Civil duhet t'i dorëzohet 1 (një) kopje Entit Publik Albcontrol.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenit 41/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate. Ky kriter vendoset mbështetur në Urdhërin e Ministrisë nr.85 datë 02.08.2012 “Për miratimin e Rregullores për kalibrimin e instalimeve aeronautike nga ajri”, neni 3, pika 3.1 citon: OSHLA duhet të siguroj që kalibrimi është kryer vetëm nga Organizata e Kalibrimit nga Ajri (OKA-t), paraprakisht të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Sqarojmë se Albcontrol, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregulloreve Europiane dhe të audituar nga ana e Agjencisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA), ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve kombëtare dhe ndërkombëtare të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit Europian si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

***Shënim:** Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e L.P.P.(i ndryshuar), si dhe nenin 43, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës*

të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/b të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet :b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;...”.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve: 2022, 2023, 2024 të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

**Shënim:** Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistritit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

#### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- 2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:
- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose e perditesuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
  - **ISO 27001:2022 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”** ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.

Çertifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, ose ekuivalente me to.

**Argumentim:** Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një

organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Sqarojmë se ALBCONTROL SHA, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjencisë Europiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë kompatibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit Europian EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative. ALBCONTROL është gjithashtu i çertifikuar, për shkak të natyrës së aktivitetit me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2018, SES (Reg 2017/373).

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqëse sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose në përdorim minimumi dy avionë me sistemin permanent FIS (Flight Inspection System) i vërtetuar me çertifikatat përkatëse, për të kalibruar / kontrolluar nga ajri, për të kryer një kalibrim special me kërkesë të Albcontrol në një kohë sa më të shpejtë. (konform specifikimeve teknike)

- Për mjetet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentet që vërtetojnë se këto mjete i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontrate dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenit 41/4 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate.

Sistemi permanent FIS (Flight Inspection System) i referohet një pajisjeje të avancuar që instalohet në avionë për të kalibruar dhe kontrolluar nga ajri sistemet e navigimit dhe uljes së avionëve të tjerë (infrastruktura tokësore) Përdoret për të kontrolluar saktësinë e pajisjeve të navigimit në aeroporte.

Fluturimet e inspektimit dhe kalibrimit të pajisjeve Navigacionale, përfshijnë vlerësimin dhe çertifikimin e sinjalit të emetuar nga këto pajisje në hapësirë. Proçesi i vlerësimit kryhet duke përdorur

avionë të pajisur posaçërisht me instrumente matës specifike. Gjithasthu ky avion kryen procedura dhe manovra të veçanta të fluturimit për kryerjen e këtyre matjeve. Të dhënat e regjistruara në këtë mënyrë analizohen dhe përpunohen. Këto të dhëna, parametra, përcaktojnë gjëndjen e pajisjes së inspektuar, kalibruar. Inspektimi ajror është i detyrueshëm sipas ICAO Aneksin 10, ICAO doc 8071 dhe Urdhërit nr 85 të Ministrit të Transportit. Si dhe në bazë të Urdhrit të Ministrit Nr. 193 të datës 06.10.2022 si dhe bazuar EU Reg No 2017/373, Albcontrol-it i lind detyrimi që të sigurojë ofrimin e shërbimit të navigimit në përputhje me standartin.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë një sistem modern dhe automatik për kryerjen e inspektimeve, kalibrimeve i lidhur me avionin dhe autopilotin në mënyrë që të jetë në gjëndje të ofrojë precizion dhe përsëritje të lartë matjeve. Sistemi automatik i inspektimit duhet të jetë i instaluar në aeroplan në përputhje me Certifikatën e Tipit Shtesë lëshuar nga EASA.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate. Paisjet e përdorura në avion dhe në terren duhet të jenë të kalibruara në përputhje me standardet e institutit përkatës ndërkombëtar, kombëtar të standardeve dhe teknologjive.

Ky kriter bazohet në Rregulloren (BE) Nr. 748/2012, datë 03.08.2012, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 57, datë 13.03.2024, si dhe në Rregulloren (BE) 2018/1139, të transpozuar në legjislacionin vendas me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1095, datë 24.12.2020.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Deklaratën e konformitetit me Rregulloren e Komisionit të BE-së Nr. 965/2012 për operimet ajrore për Fluturime Inspektimi dhe Validimin e Procedurave të Fluturimit me Instrumente, duke deklaruar gjithashtu:

- Përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në Aneksin V të Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, si dhe me kërkesat e Rregullores (BE) Nr. 965/2012.
- Dokumentacioni i sistemit të menaxhimit, përfshirë manualin e operimeve, është në përputhje me kërkesat e Aneksit III (Part-ORO), Aneksit V (Part-SPA), Aneksit VI (Part-NCC) ose Aneksit VIII (Part-SPO) të Rregullores (BE) Nr. 965/2012, dhe të gjitha fluturimet do të kryhen në përputhje me dispozitat e manualit të operimeve, siç kërkohet nga pika ORO.GEN.110(b) e Aneksit III të kësaj rregulloreje.

Kjo deklaratë duhet të paraqitet së bashku me konfirmimin pasues nga Autoriteti i Aviacionit Civil përkatës.

*Argumentimi:* Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të L.P.P.: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar edhe bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 4/a të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është përcaktuar:

“...4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;...”.

Ky kriter bazohet në Rregulloren e BE-së 965/2012, të transpozuar në legjislacionin kombëtar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 80, datë 30.06.2023 (ndryshuar me Urdhrin Nr. 152, datë 10.10.2025).

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Certifikatë të Vlefshmërisë Ajrore (COFA) dhe një Certifikatë të Rishikimit të Vlefshmërisë Ajrore (ARC) për avionin e deklaruar, në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 1321/2014, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 79, datë 15.04.2024, me Rregulloren (BE) Nr. 748/2012, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 57, datë 13.03.2024, si dhe me Rregulloren (BE) 2018/1139, të transpozuar në legjislacionin vendas me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1095, datë 24.12.2020.

*Argumentimi:* Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të L.P.P.: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar edhe bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 4/a të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është përcaktuar:

“...4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;...”.

Ky kriter bazohet në Rregulloren (BE) Nr. 1321/2014, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 79, datë 15.04.2024, në Rregulloren (BE) Nr. 748/2012, datë 03.08.2012, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të

*Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 57, datë 13.03.2024, si dhe në Rregulloren (BE) 2018/1139, të transpozuar në legjislacionin vendas me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1095, datë 24.12.2020.*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Certifikatë të vlefshme të Miratimit të Organizatës për Menaxhimin e Vazhdimësisë së Vlefshmërisë Ajrore (CAMO), të lëshuar nga Autoriteti përkatës i Aviacionit Civil, në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 2042/2003, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Transportit Nr. 110, datë 02.10.2012, si dhe me Rregulloren (BE) Nr. 1321/2014, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 79, datë 15.04.2024, si dhe me Aneksin 6 dhe Aneksin 8 të ICAO-s.

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të L.P.P.: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar edhe bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 4/a të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është përcaktuar:*

*“...4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;...”*

*Ky kriter bazohet në Rregulloren (BE) Nr. 2042/2003, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Transportit Nr. 110, datë 02.10.2012, si dhe me Rregulloren (BE) Nr. 1321/2014, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 79, datë 15.04.2024, si dhe me Aneksin 6 dhe Aneksin 8 të ICAO-s.*

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Certifikatë të vlefshme të Kalibrimit të Sistemit të Inspektimit në Fluturim për sistemin e inspektimit në fluturim në bordin e avionit, në përputhje me ICAO Doc 8071, Aneksin 10 të ICAO-s, si dhe me Rregulloren (BE) 2017/373, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 193, datë 06.10.2022 (me ndryshimet përkatëse).

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të L.P.P.: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar edhe bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 4/a të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është përcaktuar:*

*“...4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;...”.*

*Ky kriter bazohet në ICAO Doc 8071, Aneksin 10 të ICAO-s, si dhe me Rregulloren (BE) 2017/373, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 193, datë 06.10.2022 (me ndryshimet përkatëse).*

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 4 pilotë me Licencë të vlefshme të Ekuipazhit Fluturues (Flight Crew Licence) për avionin/ët që do të përdoren në këtë kontratë, me kompetencë të vlefshme. Për të përmbushur këtë kërkesë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Licencën e Ekuipazhit Fluturues ATPL (A) për avionin/ët e kërkuar në pikën 3.2 të Specifikimeve Teknike, me vlefshmëri përkatëse për Instrument Rating (IR), Multi Engine (ME), si dhe një Certifikatë të vlefshme të Kompetencës, në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 1178/2012, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 178, datë 20.12.2023.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të L.P.P.: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar edhe bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 4/a të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është përcaktuar:*

*“...4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;...”.*

*Ky kriter bazohet në Rregulloren (BE) Nr. 1178/2012, të transpozuar në legjislacionin vendas me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 178, datë 20.12.2023.*

*Kriteri i mësipërm është i nevojshëm për të siguruar një garanci të arsyeshme për përmbushjen e aktiviteteve të kontratës, ku për çdo avion të kërkuar duhet të ketë dy pilotë për operim.*

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Fondi limit dhe Specifikimet teknike janë hartuar nga dy grupe të posaçme, të cilat janë ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për përllogaritjen e fondit limit, si dhe hartimin e specifikimeve të teknike, në përputhje me nenet 4, pika 38/b, nenin 34 dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, dhe nenin 76 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në proporcion të drejtë me tipologjinë e shërbimit të kërkuar duke shprehur të dhënat minimale që duhen për realizimin me sukses të kontratës.

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën e veçantë (Specifikimet Teknike) tek Dokumentat e Tenderit (D.T.)*

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Shënim:** *Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e Dokumentave të Tenderit (D.T.) ngarkuar në S.P.E. e A.P.P., për shërbimet objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të L.P.P., si dhe nenit 41, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

**Kujdes:** *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e*

*kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të L.P.P.. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **Njësia e Prokurimit**